



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:069954

Datë: 15.01.2025

Numri i dokumentit: 06778823

2024:069965

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me procesmbajtësen-praktikanten Djellza Hoxha, në çështjen penale kundër të pandehurit E.H., duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.174/24, të datës 12.12.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit në njërën anë dhe të dëmtuarit B. S., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 88/24 të dt. 29.02.2024, për shkak të veprës penale Pengim i personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 401 paragrafi 2 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 15.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja ND.nr. 174/24, e datës 12.12.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit E. J. H. nga fsh. . . . K., i lindur me dt., me nr. personal, në njërën anë dhe të dëmtuarit B. A. S.. nga ..., rruga “.....” në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 88/24 e dt. 29.02.2024 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit E.H., për shkak të veprës penale Pengim i personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 401 paragrafi 2 të KPRK-së,

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II. nr. 88/24 të dt. 29.02.2024, ka akuzuar të pandehurin për veprën penale Pengim i personit zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 401 paragrafi 2 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt. 10.12.2024, konform 229 të KPP-së, dhe nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 12.12.2024, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, është arritur marrëveshja ND.nr. 174/24, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 15.01.2025, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
2024:069955, datë 15.01.2025.

Procesmbajtëse-praktikante
Djellza Hoxha

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.